

*fq. 2**ePeriodik*

AMF thellon bashkëpunimin me Autoritetin Federal të Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin) në drejtim të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse në fushën e fondeve të investimeve

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar - shkurt 2014 *fq. 2-3*

ZHVILLIME TË TJERA

- » AMF mbështet reformën në kolonën e dytë të pensioneve *fq. 4-6*
- » Takime të komiteteve të IAIS-it *fq. 7*
(17-19 mars, Bazel)
- » Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit të siguruesve në një regjim me bazë risku *fq. 8*
(12-14 mars, Bazel)

LAJMET NGA RAJONI

- » Konferenca Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit në Shërbimet Financiare *fq. 9*
(Bukuresht, Rumani)
- » Armeni » Azerbajxhan » Bullgari *fq. 10*
- » Estoni » Letoni *fq. 11*

EDUKIMI I KONSUMATORIT

fq. 12-15

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF thëllon bashkëpunimin me Autoritetin Federal të Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin) në drejtim të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse në fushën e fondeve të investimeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në bashkëpunim Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC), organizuan në datat 11-13 mars konsultime mbi mbikëqyrjen e fondeve të investimeve. Qëllimi i zhvillimit të konsultimeve ishte ngritja e kapaciteteve të stafit mbikëqyrës të AMF-së, duke ndarë me ekspertët praktikant më të mira të fushës.



Gjatë takimeve për mbikëqyrjen e fondeve të investimeve

Gjatë vitit 2013 në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve "Raiffeisen Prestigj" dhe Fondi i Investimeve "Raiffeisen Invest Euro" me një total të vlerës neto të asetëve prej 50.3 miliardë lekë dhe 28,442 anëtarë.

Konsultimet u fokusuan tek mbikëqyrja e fondeve të investimeve, mbikëqyrja e likuiditetit të fondeve të investimit, kuadri rregullator në BE, studimi i disa praktikave të manipulimit të tregut, etj.

Gjatë vitit 2013 në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve "Raiffeisen Prestigj" dhe Fondi i Investimeve "Raiffeisen Invest Euro"

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 30.23% gjatë periudhës janar-shkurt 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 1.72 miliardë lekë. Kjo u shoqërua edhe me rritje të numrit të policave të sigurimit me rreth 2.60%, duke arritur në 134,741 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut janë dëmet e paguara bruto. Gjatë periudhës janar-shkurt 2014 dëmet e paguara bruto u rritën me 0.54% në krahasim me periudhën janar-shkurt 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.27 miliardë lekë, apo 67.92% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Tregu i sigurimeve u rrit me 30.23% gjatë periudhës janar-shkurt 2014

SIGURIMI I JO-JETËS

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 32.59% gjatë periudhës janar-shkurt 2014, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 0.86 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shkurt 2014, duke shënuar një rritje prej 28.40% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-shkurt 2014 përbëjnë 50.32% të volumit total të primeve në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës.

KLASA TË TJERA NË SIGURIMET E JO-JETËS

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 22.48% të tregut të Jo-Jetës;
- » *sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme* të cilat së bashku zunë 13.72% të tregut të Jo-Jetës.

SIGURIMI I JETËS

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 7.05% krahasuar me periudhën janar-shkurt të vitit 2012. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “*Jetë debitor*” dhe përbën 43.10% të sigurimit të Jetës.

NDARJA E TREGUT TË SIGURIMEVE, JANAR-SHKURT 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA



Gjatë punimeve të Forumit të II-të Financiar të Shqipërisë

Në Forumin e II-të Financiar që u zhvillua më 26 mars 2014 me pjesëmarrje nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, institucione të rëndësishme në vend, si dhe aktorë të tregjeve financiare u diskutuan zhvillimet e fundit financiare në vend, sfidat kryesore për ekonominë dhe financat e vendit, si dhe rruga drejt zhvillimit të tregut financiar në Shqipëri.

Kryetarja e AMF-së Zj. Enkeleda Shehi, pjesëmarrëse në takim, dha disa mesazhe të rëndësishme, të cilat lidhen me zhvillimin e tregut të letrave me vlerë dhe atij të pensioneve.

Më poshtë fjala e plotë e Kryetares së AMF-së në këtë Forum.

Thelbi i të gjithë këtyre diskutimeve ka qenë *nevoja për të zhvilluar sektorin financiar dhe për të forcuar kapacitetet e autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse*, që të jenë në gjendje të trajtojnë me efektshmëri çështje komplekse të tregjeve financiare. Në të vërtetë është një kënaqësi për mua të jem sot këtu, për të folur për drejtimin dhe orientimin e zhvillimit të tregjeve financiare, që mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF).

AMF është autoriteti rregullator dhe mbikëqyrës i tregut të sigurimeve, tregut të kapitaleve, ku përfshihen fondet e investimeve kolektive, të tregut të fondeve të pensioneve, si edhe të çdo veprimtarie tjetër financiare jo-bankare. *Tregjet financiare në Shqipëri janë relativisht të vegjël* nisur nga madhësia dhe kontributi që ata kanë në ndërmjetësimin financiar.

Megjithatë, dinamika e vërejtur në zhvillimin e tregjeve të tilla pothuaj ka qenë intensive. Totali i aktiveve i shprehur në përqindje ndaj PBB-së për këto tregje në vitin 2013 ka arritur në 5.3% nga 1.7% që ishte mesatarisht për periudhën 2007-2012, kryesisht si rrjedhojë e zgjerimit të veprimtarisë së fondeve të investimit. Numri gjithsej i njësive të

Kryetarja e AMF-së
Zj. Enkeleda Shehi,
pjesëmarrëse në takim,
dha disa mesazhe të
rëndësishme, të cilat
lidhen me zhvillimin
e tregut të letrave me
vlerë dhe atij
të pensioneve.

mbikëqyrura në dhjetor të vitit 2013 arriti 480, prej të cilave 53 janë të licencuara si persona juridikë dhe pjesa tjetër si individë. Mbi të gjitha, çështjet me të cilat përballemi në secilin prej këtyre tregjeve e rritin shkallën e kompleksitetit të situatave. AMF është një organizatë disi e vogël për tre tregje relativisht të ndryshme nga njëri-tjetrit, të cilat kanë nevojë të mbikëqyren për çdo ditë. Përveç kësaj, niveli relativisht i ulët i zhvillimit nënkupton që AMF duhet të bëjë shumë përpjekje për të nxitur zgjerimin e tregjeve financiare dhe zhvillimin e produkteve në to.

Kriza më e fundit financiare botërore na ka dhënë disa mësimë shumë të mira në lidhje me rolin e autoritetit rregullator, nevojën për të forcuar procesin mbikëqyrës dhe rregullator, nxitjen e qëndrueshmërisë Financiare, si edhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve rregullatore në vend dhe më gjerë.

Institucionet financiare, të ndryshme nga bankat, shërbejnë si kanale shtesë në financimin e ekonomisë, të cilave u rritet rëndësia në situatat e ngërçit të kreditimit. Gjithashtu, ato ofrojnë produkte financiare që nxitin kursimin afatgjatë dhe mbrojtjen nga marrja përsipër e rreziqeve të tepërta. Për rrjedhojë, këto institucione financiare janë të rëndësishme për zhvillimin e sektorit financiar, pasi produktet e tyre kontribuojnë në reduktimin e problemeve financiare dhe shoqërore në të ardhmen dhe shtojnë mirëqenien në përgjithësi. Për të qenë në gjendje të kryejnë funksione të tilla, është tepër e rëndësishme të sigurohemi që institucionet financiare drejtohen mirë dhe veprojnë në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme.

Për rrjedhojë, për periudhën afatmesme AMF synon të orientojë dhe të drejtojë zhvillimin e tregjeve financiare nëpërmjet marrjes së masave të stabilizimit të tregut dhe masave të tjera për zgjerimin dhe thellimin e tregjeve. Strategjia afatmesme për tregjet financiare mbështetet në shtyllat e mëposhtme:

- » **Nxitja e mbrojtjes konsumatore**, nëpërmjet forcimit të rregullave për transparencën dhe rritjen e thjeshtësisë së dhënies së informacionit nga institucionet financiare për klientët e tyre;
- » **Zhvillimi i mbikëqyrjes së konsoliduar**, që nënkupton bashkërendim më të mirë me autoritetet e tjera mbikëqyrëse, veçanërisht në fushën e mbikëqyrjes së fondeve të investimeve;
- » **Përmirësimi i funksionimit të tregut të sigurimeve**, nëpërmjet vendosjes së standardeve të përcaktuara mirë për krijimin e rezervave monetare për produktin MTPL apo rivendosjen e qëndrueshmërisë në financimin e fondit të kompensimit, të cilat janë masa afatshkurtra stabilizimi. Në periudhë afatgjatë AMF po përpiqet të punojë së bashku me shoqëritë e sigurimit për të thelluar tregun e sigurimeve, nëpërmjet zhvillimit të produkteve të sigurimit të përgjegjësive për shërbimet profesionale, si edhe të produkteve të sigurimit nga rreziku katastrofik;
- » **Nxitja e zhvillimit të tregut të kapitaleve dhe tregut të fondeve të pensioneve private**. Në diskutimin tim do të përqendrohemi në këtë shtyllë pasi zhvillimi i dy tregjeve është i ndërthurur dhe në rastin e Shqipërisë është e nevojshme që zhvillimi i të dy tregjeve të nxitet së bashku.

Për shkak të së kaluarës së vet financiare, pranohet që Shqipëria është një vend me ekonomi kryesisht në bazë paraje. Ndërsa një tipar i tillë pakëson mundësinë që qeveria të tatojë të ardhurat dhe pasuritë, kjo gjë ndikon jo mirë edhe për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë. Titujt e qeverisë janë instrumenti i vetëm për investim dhe duke ditur që nuk ka instrumente të tjera investimi, pjesa më e madhe e letrave me vlerë në treg mbahen deri në maturim. Titujt mund të tregtohen në tregun sekondar me pakicë, por likuiditeti dhe thellësia e këtij tregu është larg pjekurisë së tij.

Megjithëse globalizimi potencialisht mund t'i ofrojë një vendi dhe shoqërive tregtare të tij mundësi hyrjeje dhe veprimi në tregjet botërore të kapitalit, në fund të fundit janë vetë tregjet vendase, infrastruktura dhe institucionet shqiptare ato që do të mbeten të rëndësishme për suksesin ekonomik të tij.

Megjithatë, për të mbajtur kosto të ulëta kapitali në tregje të tilla kërkohet një sistem i fortë për qeverisjen e shoqërive dhe mbikëqyrjeje nga ana e autoritetet rregullator. AMF, në bashkëpunim me FSVC, mori iniciativën për të hartuar një strategji të zhvillimit të tregut të titujve në Shqipëri. Pavarësisht se sa e mirë është strategjia, ajo ka nevojë për vëmendjen dhe bashkëpunimin e të gjithë palëve të përfshira. Duke ditur se cila është gjendja e tregjeve, konkludohet se nuk ka një zgjidhje të vetme në krijimin e një tregu kapital veprues në Shqipëri. Prandaj, kërkohet një përqasje gjithanshme që merr parasysh të gjitha palët e interesuara, të tilla si Ministria e Financave, e Ekonomisë, etj.

Disa veprime më të prekshme dhe afatshkurtra mund të jenë krijimi i një sistemi të tregut sekondar për tregtimin e obligacioneve të qeverisë dhe ristrukturimi i sistemit të pensioneve private.

Meqenëse ekziston një treg i obligacioneve qeveritare, një pikënisje e mirë do të ishte krijimi i një platforme tregtimi të obligacioneve në BT (Bursa e Tiranës) që të lejojë tregtimin e obligacioneve të qeverisë në tregun sekondar. Duke parë shtimin e likuiditetit dhe vlerësimin përmes procedurash më transparente, investitorët mund të shfaqin interes në potencialin e një tregu titujsh të kapitalit të vet. Në lidhje me platformën e ekzekutimit të urdhrave, do të shqyrtohet dhënia e nxitësve për ndërmjetësit, të cilët ofrojnë likuiditet (ofertë ose kërkesë si kundërpalë), nëpërmjet mekanizmit të uljes së çdo tarife të mundshme për shpenzimet e pjesëmarrjes. Tarifat e pjesëmarrjes do të jenë të tilla që të subvencionojnë koston e funksionimit të kësaj linje.

Përpjekjet për të zhvilluar tregun e kapitalit janë në harmoni me pikëpamjen afatgjatë të reformimit të sistemit të pensioneve, duke u përqendruar kryesisht në nxitjen e kolonës së tretë dhe në ngritjen e kolonës së dytë. Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm investimi është jetësor për të ulur varësinë prej titujve qeveritarë dhe për të rritur diversifikimin. Si rezultat, fondet e pensioneve mund të kontribuojnë në rritjen e kërkesës për gamën e produkteve financiare që ofrohen nga tregu i kapitalit. Nga ana tjetër, fondet e pensioneve mund të jenë një faktor i rëndësishëm për të imponuar disiplinë në qeverisjen e shoqërive aksionare në një vend. Një rast i tillë nuk duhet anashkaluar, por duhet konsideruar si një element thelbësor për zhvillimin e tregut të kapitalit. Si i tillë, AMF e

konsideron **reformën për kolonën e dytë si të një rëndësie shumë të madhe dhe shpreh gatishmërinë për të drejtuar këtë reformë**, me mbështetjen e të gjithë aktorëve institucionalë dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke ndjekur rekomandimet e FSAP.

Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe rëndësinë e një reforme të tillë, AMF po punon për të **forcuar kapacitetet mbikëqyrëse për këtë segment të veçantë të tregut financiar**, si edhe për të bashkërenduar përpjekjet me Ministrinë e Financave në lidhje me harmonizimin e nxitësve fiskalë për kolonën e tretë të pensioneve.

Takime të Komiteteve të IAIS-it mbi principet e standardet për stabilitetin financiar

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*), në bashkëpunim me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (*Bank for International Settlements, BIS*) zhvilluan më 17-19 mars 2014 në Bazel, Zvicër, takimet e Komiteteve dhe Nënkomiteteve të IAIS-it.

Qëllimi i takimeve ishte ritheksimi i principeve, standardeve për stabilitetin financiar, si dhe mbështetja dhënë disa çështjeve lidhur me mbikëqyrjen në sigurime.

Në Nënkomitetin e Edukimit, pjesëmarrësit diskutuan ndër të tjera për programin FSI Connect (trajnim *online*), i përdorur gjerësisht nga mbikëqyrësit e sektorit financiar në gjithë botën si edhe për organizimin e seminareve rajonale.

Në Nënkomitetin e Zbatimit të Standardeve u diskutua mbi:

- » Programin *Self-Assessment and Peer Review* (vetëvlerësimi). Pjesëmarrësit theksuan domosdoshmërinë e vazhdimin të punës për rishikimin e ICP-ve (parimet bazë të sigurimeve sidomos ICP 6 dhe ICP 12);
- » Procesin e vendosjes dhe zbatimit të parimeve bazë të cilat duhen mbështetur fuqimisht edhe nëpërmjet iniciativave edukuese dhe trajnuese të anëtarëve të tij për të lehtësuar zbatimin efektiv të ICP-ve.

Në takimin e Komitetit Ekzekutiv të IAIS-it u mbajt raport i aktivitetit të Sekretariatit dhe u raportua mbi përgatitjen e propozimeve për takimet e ardhshme të KE-së, ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme të IAIS-it në kuadër të krizës financiare, zgjerimin e rolit të FSF-së (Forumi i Stabilitetit Financiar), u diskutua për draftin e *Risk Appetite Statement* të paraqitur nga Komiteti i Auditimit dhe Riskut, etj. Krijimi i një force të re të posaçme për zhvillimin e strategjisë së IAIS-it për vitet 2015 - 2019 pritet të përfundojë në tetor 2014.

Qëllimi i takimeve ishte ritheksimi i principeve, standardeve për stabilitetin financiar, si dhe mbështetja dhënë disa çështjeve lidhur me mbikëqyrjen në sigurime.

Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit të siguruesve në një regjim me bazë risku

Instituti për Stabilitetin Financiar (FSI), organizoi më 12-14 mars 2014 në Bazel, Zvicër seminarin me temë “Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit të siguruesve në një regjim me bazë risku”.

Temat kryesore që u trajtuan në seminar u prezantuan nga ekspertë të fushës së menaxhimit të riskut në sigurime dhe drejtues të nivelit të lartë të rregullatorëve të sigurimeve në botë. Prezantimet kishin të bënin kryesisht me:

- » Parimin 17 për mjaftueshmërinë e kapitalit;
- » Qasjet për të përcaktuar kërkesat për kapital në grup;
- » Perspektivat aktuariale mbi kërkesat e kapitalit;
- » Përcaktimin e pjesës së zbritshme të tarifave në kontratat e sigurimit, sipas këndvështrimit aktuarial;
- » Vlerësimin e Provigjoneve Teknike sipas kërkesave të IFRS 4;
- » Vlerësimin sasior të Aftësisë Paguese sipas Solvency II;
- » Modelet e brendshme të mjaftueshmërisë së kapitalit në Zvicër;
- » Vlerësimin e mjaftueshmërisë së Kapitalit në një grup sigurimi;
- » Rolin e Kapitalit në klasifikimin e riskut sipas mbikëqyrjes me bazë risku.

Gjatë seminarit u prezantua se si mbikëqyrësit në sigurime mund të përshtaten me kërkesat e parimeve bazë të sigurimeve mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, duke përfshirë edhe shembuj praktikë.

Po ashtu u prezantua puna e bërë nga IAIS në zhvillimin e standardit global për kapitalin e grupeve të sigurimeve që janë aktivë në arenën ndërkombëtare. Në seminar u theksua kërkesa për kapitalin e siguruesve që është shumë i rëndësishëm për sistemin global.

Temat e trajtuara si dhe diskutimet e mbajtura gjatë seminarit patën rëndësi në njohjen e metodave të përdorura nga aktuarët si dhe analistët e menaxhimit të riskut, lidhur me vlerësimin e riskut, sinjalet paralajmëruese të situatave kritike (me nivel të lartë risku) gjatë punës së mbikëqyrësve në tregun e sigurimit.

Në seminar u theksua kërkesa për kapitalin e siguruesve që janë shumë të rëndësishëm për sistemin global.

LAJMET NGA RAJONI

Konferenca Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit në Shërbimet Financiare (Bukuresht, Rumani)

www.xprimm.com

“Kthimi i besimit të konsumatorit në shërbimet financiare është një përparësi strategjike për të gjithë ne, lojtarët e tregut, mbikëqyrësit kombëtarë dhe organet evropiane”. Kjo deklaratë u bë nga Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) me rastin e Konferencës Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit në Shërbimet Financiare. “Ai theksoi se një mbikëqyrje e fortë shton besueshmërinë në treg, rregullimi i mirë është vetëm hapi i parë, ndërsa zbatueshmëria e vendimeve dhe e rregullimit është vendimtare për të siguruar një mbrojtje të vërtetë dhe efektive të konsumatorit”.

Sipas EIOPA-s, mbrojtja e konsumatorit ka dy çështje kryesore ku do përqendrohet në njërën anë mbikëqyrësit duhet të jenë të sigurt që siguruesit kanë një pozitë të fuqishme të aftësisë paguese dhe për këtë arsye janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre ndaj të sigurvearit dhe nga ana tjetër, ata duhet të sigurohen që konsumatorët janë trajtuar në mënyrë të drejtë, të marrin paratë e tyre dhe të kenë akses në informacionin e duhur rreth produkteve të sigurimit.

Besimi i konsumatorëve në kontekstin global të rritjes së ndërkomunikimit ndërmjet sektorëve financiarë ishte tema kryesore e diskutimit të Z. Peter Braumuller, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të IAIS-it. “Megjithëse kjo nuk është aktualisht e pranishme në të gjitha vendet, rritja e bashkëveprimit është në fakt një trend global. Tani ne jemi të vetëdijshëm për atë që ka ndodhur në SHBA ose në ndonjë vend tjetër të botës që po ndikon në sistemin global. Prandaj, qasja duhet të marrë në konsideratë se ne nuk jemi të izoluar, ne jemi të lidhur me ambientin e jashtëm. Kjo është arsyeja pse ne përpiqemi të marrim më shumë informacion dhe të bashkëpunojmë më shumë”, theksoi Braumuller.

Tematika e konferencës ofroi gjithashtu mundësinë për një diskutim të zgjeruar mbi ngjarjet e fundit të cilat prekën tregun rumun të sigurimeve, duke minuar fuqishëm besueshmërinë e tregut, si dhe besimin e publikut në sistemin financiar kombëtar mbikëqyrës.

Gjatë konferencës u prezantuan studime të rasteve përkatëse, duke theksuar mundësitë e ndryshme që mbikëqyrësit, lojtarët e tjerë të tregut ose sigurvearit kanë për rritjen e mbrojtjes së konsumatorëve, përmirësimin e sjelljes së tregut dhe rritjen e besimit të publikut në sektorin e shërbimeve financiare.

Kthimi i besimit të konsumatorit në shërbimet financiare është një përparësi strategjike për të gjithë, lojtarët e tregut, mbikëqyrësit kombëtarë dhe organet evropiane.

ARMENI

www.xprimm.com

Në fund të vitit 2013 tregu armen i sigurimeve regjistroi një ulje prej 4.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 63.8 milion euro.

Totali i dëmeve të paguara nga shoqëritë e sigurimit arriti në 35.25 milion euro ose 29.51% më shumë se një vit më parë.

AZERBAJXHAN

www.xprimm.com

Në të dhënat e paraqitura nga Ministria e Financave të Republikës së Azerbajxhanit, në fund të vitit 2013, tregu i sigurimeve arriti në 405.67 milion AZN (monedha vendase - Azerbaiiani New Manet) ose 376.32 milion euro, duke shënuar një normë rritjeje prej 18.44% krahasuar me një vit më parë. Pagesat e dëmeve arritën në 113.77 milion euro, duke shënuar një rritje prej 30.84% krahasuar me një vit më parë.

Rritja e primeve të shkruara bruto të shoqërive të Jetës për vitin 2013 ishte 79.85% duke arritur gati në 63.80 milionë euro. Për vitin 2013, baza e rritjes së tregut të sigurimit të Jetës është mbështetur tek sigurimet vullnetare.

Për të njëjtën periudhë, primet e shkruara bruto për kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës arritën në 312.52 milion euro ose 6.08% më shumë në krahasim me një vit më parë. Pjesën më të madhe të tregut e zunë përgjegjësitë civile për pronarët e automjeteve me 17.06% të tregut të përgjithshëm, e ndjekur nga sigurimi shëndetësor me 16.13%, sigurimi Kasko me 14.02% dhe sigurimet nga zjarri dhe rreziqe të tjera të sigurimit me 11.76%.

BULLGARI

www.xprimm.com

Shifrat e publikuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë (FSC) për vitin financiar 2013, tregojnë një rritje vjetore prej 8% të tregut të sigurimeve bullgare, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 884 milion euro.

Norma e rritjes mund të ndikohet nga fakti se për vitin 2013 shifrat e tregut përmbajnë të dhënat për shoqëritë e sigurimit të specializuara në segmentin e sigurimit shëndetësor vullnetar.

Tregu i sigurimit të Jetës arriti në 156 milion euro ose 14% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar për shkak të rritjes së segmentit tradicional me 15%.

LETONI

www.xprimm.com

Komisioni i Tregut Kapital dhe Financiar (FKTK) i Letonisë publikoi të dhënat për vitin 2013, sipas të cilave tregu i sigurimeve u rrit me 5.3%, duke arritur në 471 milion euro. Primet e shkruara bruto nga siguruesit vendas ranë me 1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa primet e shkruara bruto për filialet e kompanive të vendeve të BE-së me aktivitet në Letoni arritën në 121 milion euro ose 30% më shumë se e njëjta periudhë të vitit kaluar.

Volumi i primeve të shkruara bruto në Sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 3.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërkohë që volumi i primeve të shkruar bruto për sigurimin e Jetës u rrit me 13.5%. Në të njëjtën kohë, siç tregojnë shifrat e FKTK, kompanitë e sigurimeve paguan 262 milion euro dëme.

Pjesën më të madhe të tregut e zunë sigurimet e Jetës dhe sigurimi i përgjegjësive në transport me një rritje rreth 19% për secilin prej tyre. Rritje pësuan edhe grupet e tjera të sigurimeve, si sigurimi Kasko me rritje rreth 17%, sigurimi i pronës me rreth 14%, MTPL me rritje rreth 11% dhe sigurimi shëndetësor u rrit me afro 8%.

ESTONI

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Estoni gjatë vitit 2013 patën një rritje me 24% ose rreth prej 428 milion euro. Sigurimet e Jo-Jetës shënuan ritme rritjeje mbresëlënëse me vlera dy-shifrore. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara nga siguruesit në Estoni në vitin 2013 arritën në 238 milionë euro, ose 16% më shumë se viti i kaluar.

Në sigurimet motorike, sigurimi Kasko u rrit me 21.8% krahasuar me vitin e kaluar. Sigurimet e Jo-Jetës në total shënuan një rritje të përgjithshme të primeve të shkruara bruto prej 28.5%, duke arritur në 349.2 milion euro. Rritje shënoi edhe volumi i dëmeve të paguara për sigurimin e Jo-Jetës me 34.5% gjatë vitit 2013.

Sigurimi i Jetës tregoi një rritje gati modeste në primet e shkruara bruto prej 7.6%, por u pa një reduktim i ndjeshëm i dëmeve të paguara, me gati 31 % krahasuar me vitin e kaluar.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

AMF Online


Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF, në faqen zyrtare online www.amf.gov.al ofron informacion edukativ dhe praktik në shërbim të konsumatorëve për të tre tregjet që ai rregullon.

Faqja është e ndarë në seksione për lajmet, publikimet e raporteve periodike statistikore me të dhënat e tregjeve financiare, kuadrin ligjor rregullues dhe subjektet që AMF mbikëqyr.

Një seksion i veçantë i dedikohet materialeve informative dhe edukuese, ku përdoruesit e faqes gjejnë trajtime teorike dhe studime për aspekte të veçanta të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare.

AMF ka pranë saj njësinë e trajtimit të ankesave të konsumatorëve, kontakti me të cilët ka një vend të veçantë në faqen online. Kjo strukturë do të trajtojë në mënyrë të paanshme, me profesionalizëm dhe brenda afateve të gjitha ankesat, komentet dhe opinionet që ju paraqisni.

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE, AMF, është rregullator për tregun e SIGURIMEVE, FONDEVE TË INVESTIMIT e LETRAVE me VLERË si edhe PENSIONEVE PRIVATE VULLNETARE.



Mbrojtja e Konsumatorit

- Verifikoni policën tuaj të sigurimit të detyrueshëm motorrik
- Trajtimi i ankesave të konsumatorëve
- Na kontaktoni në:
 - konsumatori@amf.gov.al
 - Tel: +355 4 2257 557
 - Tel. pa pagesë: 0800 6969
 - sms: +355 694060671

SHËRBIM NË SIGURIME

AMF ka licencuar 11 shoqëri sigurimesh të Jetës dhe Jo-Jetës që ofrojnë një gamë të gjerë produktesh sigurimi në treg. Polica juaj e sigurimit të detyrueshëm motorik është një nga këto produkte. Ju mund të verifikoni policën në faqen zyrtare online të AMF-së www.amf.gov.al.

Faqe Kryesore | Harta e Faqes | Kontaktoni

Kërko | Go

amfALBANIA **AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Plotësoni Kriteret e Kërkimit për Policën

(*) Plotësoni Targën e Mjetit dhe Numrin Serial ose Numrin e Shasisë

Lloji i policës:

* Targa e Mjetit:

Fusha "Targa e Mjetit" mund të përmbajë vetëm shkronja dhe numra, pa hapësira boshë. P.sh TR0001A

* Numri Serial:
Fusha "Numri Serial" duhet të përmbajë vetëm numra. P.sh 034567

* Numri i Shasisë:
Fusha "Numri i Shasisë" mund të përmbajë vetëm shkronja dhe numra

Nëse policia nuk gjendet, ju lutem njoftoni AMF-në në adresën konsumatori@amf.gov.al ose në telefon [+355 4 2257557](tel:+35542257557).

Njoftojmë konsumatorët që në momentin e blerjes së policës të sigurohen që:

- policat të jetë e printuar në kompjuter
- policat të përmbajë kodin identifikues të raportimit
- kategoria e mjetit të përcaktuar në policë të jetë e njëjtë me atë të përcaktuar në dokumentet shoqëruese të mjetit.
- policat të përmbajë primin e sigurimit.

Mos zbatimi i pikave të mësipërme përbën shkelje ligjore dhe mund të sjellë mospërbushje të të drejtave të konsumatorëve në rastet e trajtimit të dëmeve.

Çdo policë e sigurimit të detyrueshëm motorik lëshohet nëpërmjet sistemit kompjuterik të lidhur online me AMF. Polica ka të printuar një kod numrash e shifrash, 15 karaktere, që përbëjnë kodin identifikues të raportimit, të gjeneruar në kohë reale nga serverat e Autoritetit.

Gjithashtu, policat e sigurimit ka të shënuar edhe kodin e transaksionit bankar të pagesës. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të afishojnë çmimet e policave të sigurimit të detyrueshëm në çdo pikë të tyre të shitjeve.


Ju mund ta kontrolloni policën tuaj të sigurimit edhe nëpërmjet një sms në numrin falas që ofron AMF në + 355 69 4060671. Shënoni në sms targën e automjetit tuaj dhe do të merrni një konfirmim nëse ju keni një policë sigurimi që rezulton rregullisht e mbuluar me sigurim të detyrueshëm motorik. Ky sistem ju krijon edhe mundësinë të njoftoheni, me anën e një sms, tri ditë para mbarimit të periudhës së sigurimit të detyrueshëm.

ALTERNATIVA INVESTIMI

Letrat me vlerë të Qeverisë janë ndër mundësitë e rëndësishme të investimeve në tregun e kapitaleve. Si individë, ju mund të investoni në Bono Thesari (me afat maturimi deri në një vit) dhe Obligacione (me afat maturimi deri në 10 vjet) drejtpërdrejt nëpërmjet bankave të nivelit të dytë, të licencuara nga AMF. Pranë Bankës së Shqipërisë dhe Postës Shqiptare sh.a. subjektet juridike mund të investojnë vetëm për Bonot e Thesarit.

Në faqen zyrtare të AMF-së ju mund të gjeni pasqyrimin e përditësuar të transaksioneve dhe kuotimeve në një datë të caktuar, të kuotimeve të ndryshme të letrave me vlerë, si edhe komisioneve që ndërmjetësit financiarë përdorin për veprimet që ju kryeni.

Shuma minimale për qytetarët për të marrë pjesë në blerjen e Bonove të Thesarit është 300,000 lekë.



The screenshot shows the GSRM (Government Securities Retail Market) website interface. At the top, there are navigation links for 'Page Kryesore', 'Login', and 'English' with a flag icon. The main heading is 'GSRM Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë Government Securities Retail Market'. Below this, there are several search filters: 'Data 12/12/2018', 'Maturimi' (dropdown menu), 'DDM' (dropdown menu), 'Ndërmjetësit Financiar' (dropdown menu), and 'Lloji i Transaksionit' (dropdown menu). A 'Filtra' button is located below the filters. On the left side, there is a sidebar menu with the following items: 'TREBTIMI', 'Kuotimet & Transaksionet Ditore' (with sub-items 'Lloji B, C' and 'Lloji A, D, E'), 'Të Gjitha Kuotimet për një Letër me Vlerë të Caktuar', 'Tregimi në një Datë të Caktuar', and 'Komisionet të Aplikuar nga NF'. A red arrow points from the 'Maturimi' dropdown menu to the 'Kuotimet & Transaksionet Ditore' section in the sidebar.

Një mundësi e re investimi për qytetarët është edhe pjesëmarrja në fondet e investimeve. AMF ka licencuar dy fonde për investime, në lekë Raiffeisen Prestigj dhe në euro Raiffeisen Invest Euro. Shuma më e vogël e investimit është përkatësisht 5,000 lekë dhe 250 euro. Me pjesëmarrjen në këto fonde, qytetarët vendosin t'i investojnë kursimet e tyre në portofole investimi të cilat nëpërmjet një menaxhimi profesionist synojnë kthimin e investimit me fitim për ta. Këto investime nuk kanë të njëjtën mbrojtje si depozitat dhe prandaj ofrojnë norma më të larta fitimi.

ZGJIDH PENSIONIN TËND

Fondet e pensioneve private, vullnetare dhe investimi aty i një pjesë të kursimeve, janë një mundësi e mirë për të planifikuar dhe zgjedhur vetë atë se çfarë do të marrësh si pension.

Secili prej jush mund të marrë pjesë në këto fonde pensionesh private, vullnetare. Skema e përfshirjes në fond, mund të jetë individuale, ku vetëm ju kontribuoni dhe vendosni për sasinë dhe periodicitetin e investimit në këtë skemë. Skema e përfshirjes mund të jetë edhe skemë profesionale investimi, ku si ju edhe punëdhënësi juaj kontribuojnë për pension tuaj privat.

- Shoqëritë Administruese të Fondëve të Pensioneve Vullnetare
 - RAIFFEISEN INVEST
 - SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE Sh.a.
 - SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a
 - SHOQERIA ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT SICRED SH.A
- Depozitarë të Aseteve të Fondit të Pensionit Vullnetar

Fondet e Pensioneve Private Vullnetare >> Shoqëritë Administruese të Fondëve të Pensioneve Vullnetare

RAIFFEISEN INVEST.SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE Sh.a.	
Drejtor Ekzekutiv	Resmi HEBRAJ
Fusha e Aktivitetit	Për të vepruar si shoqëri administruese e fondëve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondëve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe në administrimin e asetëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me Kapital të huaj
Adresa e Selisë	Bhv. Bajram Curri, ETC, kati 110, Tiranë
Tel./Faks	+355 4 2277 901, +355 4 2277 905
Faqja e Internetit	www.raiffeisen-invest.al
Posta Elektronike	invest@raiffeisen.al
Licenca	nr. 1, date 13.12.2011 (pa afat)

FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN (Ref. FP 1)	
NËN ADMINISTRIMIN E "RAIFFEISEN INVEST- SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE" Sh.a.	

Ju lidhni një kontratë me Fondin e Pensionit tek i cili zgjidhni të investoni. AMF ka licencuar dhe mbikëqyr tri shoqëri administruese për tre fonde të tilla pensioni: SIGAL www.fppsigal.com.al; SICRED PENSIONS www.sicred-pensions.com.al. dhe RAIFFEISEN www.raiffeisen-invest.al. Në këto faqe online ju do të gjeni edhe mënyrën për të llogaritur vetë pensionin. Duke vendosur moshën kur filloni të investoni, shumat mujore të paguara në fond, moshën kur ju dëshironi të merrni pensionin, ju mund të llogarisni shumat mujore të përfitimit si pension.

Individi pjesëmarrës në fondin e pensionit privat mund të caktojë edhe një përfitues apo trashëgimtar të cilit t'ia japë të ardhurat e fituara nga ky fond pensioni privat, apo edhe mund t'i transferojë ato tek një tjetër fond pensioni.

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 / Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al / www.amf.gov.al